# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-439010**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | LVV vendos të mbështesë nesër Çitakun dhe Shalën për nënkryetarë të Kuvendit |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/lvv-vendos-te-mbeshtese-neser-citakun-dhe-shalen-per-nenkryetare-te-kuvendit/1008988/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 20:15:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 20:12:17 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `60439397fb46cff27d7c3dd9a413b2e2ec6ffe0af251bcbd3fce347a1625b74d` |
| TEKSTI | `37e417f014cd7b03e43d7593afb3cf8d4929743b80f46d116fe873d08917728a` |
| PAMJA | `31c12fd11e405e808e6858b4c56457f4dbaeac35fed590280e365a0c40fc6198` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f273085f7cdd1580044c31815917cbc314f22c3d9bb84a4e5db5f0abdb43dbe9` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `dd388b934d0fe96ade4737dd638e65c92a5b30aa74a564e89a82bae40ea67965` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f273085f7cdd1580044c31815917cbc314f22c3d9bb84a4e5db5f0abdb43dbe9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# LVV vendos të mbështesë nesër Çitakun dhe Shalën për nënkryetarë të Kuvendit



Kryesia e Lëvizjes Vetëvendosje u mblodh në një takim të jashtëzakonshëm dhe vendosi që në seancën e radhës të votojë Vlora Çitakun e PDK-së dhe Kujtim Shalën e LDK-së për postet e nënkryetarëve të Kuvendit.

Sipas LVV-së, vendimi synon të ruajë stabilitetin institucional pas zgjedhjeve të 7 qershorit dhe të shmangë mbajtjen e zgjedhjeve të reja, të cilat i konsideron të panevojshme dhe të kushtueshme për shtetin, qytetarët dhe buxhetin.

Seanca konstituive pritet të rinisë nesër në orën 10:00. Nga PDK-ja dhe LDK-ja, Vetëvendosje pret që pas konstituimit të Kuvendit të tregojnë "konstruktivitet" dhe të marrin pjesë në votimin për presidentin e propozuar në kuadër të marrëveshjes LVV-LDK, edhe nëse vota e tyre do të jetë kundër.

LVV ka theksuar se zgjedhjet e parakohshme të përsëritura do të ishin të katërtat brenda më pak se dy vjetësh.

Në deklaratën e saj, partia në pushtet kujton se në vitin 2025, së bashku me partnerët e koalicionit parazgjedhor dhe deputetët e komuniteteve joshumicë, kishte 57 deputetë, pra katër më pak se numri i nevojshëm. Pas zbatimit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, LVV thotë se e ndryshoi katër herë kandidatin për kryetar të Kuvendit, derisa më 26 gusht u zgjodh Dimal Basha, pesë muaj pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 9 shkurtit.

Sipas LVV-së, kundërshtimi i partive opozitare ndaj kandidaturës së Albulena Haxhiut u pasua edhe nga refuzimi i kandidaturave të Donika Gërvallës, Hekuran Muratit dhe Arbërie Nagavcit.

Pavarësisht se PDK-ja dhe LDK-ja nuk kanë ndryshuar emrat e kandidatëve të tyre, kryesia e LVV-së ka vendosur të votojë për Vlora Çitakun dhe Kujtim Shalën.

Partia ka bërë të ditur se sapo deputetët e PDK-së ta ripropozojnë nesër në mëngjes Vlora Çitakun, e cila ka

të fundit/

LVV vendos të mbështesë nesër Çitakun dhe Shalën p…

Zbulohen arsyet pse dështoi transferimi i Eduardo Camavingas…

Shpërthim i fortë në një banesë pranë Bashkisë së Shkodrës, policia …

Lufta e profileve të rreme online ashpërsohet në Koso…

Elvis Plori largohet nga drejtimi i Besëlidhjes pas humbjes me…

"Isha më e mirë", Albana Osmani: Me Arbanën s'kemi qënë…

Panik në Bruksel/ Droni i paidentifikuar shfaqet mbi aeroportin e…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

edhe dy mundësi të tjera, deputetët e saj do ta mbështesin me votë.

LVV shpreson gjithashtu që Kujtim Shala, në cilësinë e nënkryetarit të ardhshëm të Kuvendit, të jetë i pranishëm në seancën ku do të votohet për Bekim Sejdiun si president, në përputhje me marrëveshjen mes LVV-së dhe LDK-së.

Shtuar më 12.09.2026 22:12

Tags: Kuvendi i Kosoves , Seanca , votimet




Lufta e profileve të rreme online ashpërsohet në Kosovë para vendimit të…



Policia zbaton plan operativ në veri të Kosovës, ndalohen automjetet me…



Dy persona akuzohen për mashtrimin e një zyrtari policor me premtimin për…



Vjosa Osmani flet për raportin me Albin Kurtin: Dallimet mes nesh…



Marshi për Liri" në Prishtinë tërheq vëmendjen e mediave ndërkombëtare



LVV zhvillon mbledhje para seancës së nesërme në Kuvend



Seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës vazhdon të dielën, ky ësh…



Osmani: Bashkëpunimi me Kurtin për Presidentin ishte zgjedhje e mirë, ia dolëm

albeu © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko... Kërko

**Kryesore**
- Erion Veliaj
- Free Esim
- Zgjedhjet 2025
- Belinda Balluku
- SPAK
- Kombëtarja

**Kategori**
- Lifestyle
- Showbiz
- Tech
- Shëndetësi
- Argetim
- Enciklopedi

**Linqet**
- Live tv shqiptare
- Moti në Shqipëri
- Travel
- Horoskopi
- Livescore
- News from Albania

**Tags**
- Edi Rama
- Albania News
- Ilir Meta
- Piranjat
- gazeta, tv, portale
- Sali Berisha

**Moti**
- Moti në Tiranë
- Moti në Prishtinë
- Moti në Shkup
- Moti në Durrës
- Moti në Prizren
- Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.